



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



PROCEDURAT E ZGJEDHJES DHE VOTIMIT PËR KRYETAR TË OIK-ut

Zgjedhja e Kryetarit të OIK-ut

- I. Kandidati që arrin të marrë 50% + 1 votë të anëtarëve prezent në raundin e parë të votimit zgjedhet Kryetar i OIK-ut.
- II. Nëse një kandidat nuk arrin që të marrë 50% + 1 votë të anëtarëve prezent në raundin e parë, atëherë në raundin e dytë shkojnë dy kandidatët të cilët kanë arritur të grumbullojnë numër më të madh të votave në Raundin e Parë.
- III. Në rast se kandidati i dytë dhe kandidati i tretë për nga numri i votave kanë numër të njëjtë të votave, përparësi do të ketë kandidati i cili ka përvoj më të madhe profesionale.
- IV. Në raundin e dytë Kryetari i OIK-ut zgjedhet kandidati i cili ka fituar së paku një votë më shumë se kundër-kandidati.
- V. Në raundin e dytë nëse rezultati është i barabartë, zhvillohet edhe një proces i votimit, derisa njëri kandidat të fitojë vota më shumë se kandidati tjetër.
- VI. Kandidatët në fletëvotim renditen sipas rendit alfabetik.
- VII. Secili kandidat ka të drejtë që të caktojë një vëzhgues nga anëtarët e Kuvendit, për të vëzhguar procesin e votimit dhe numërimit.

Procedurat e votimit

- I. Secili anëtarë i Kuvendit ftohet nga KQZ-ja për të votuar.
- II. Fletëvotimi vulozet dhe i jepet anëtarit të Kuvendit, i cili nënshkruhet në listën votuese.
- III. Fletëvotimi i pavulosur shpallet i pavlefshëm.
- IV. Secili anëtarë voton në fshehtësi në njërin nga kabinetat e votimit.
- V. Vota nuk lejohet që të fotografohet.